# DËSHMI ARKIVI

**A-457414**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Parlamenti Europian mbështet Shqipërinë: Hapa të shpejtë drejt anëtarësimit në BE |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/politika/parlamenti-europian-mbeshtet-shqiperine-hapa-te-shpejte-drejt-anetaresi-i587047` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 10:40:12 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 10:35:02 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `8d84f7811b98aaedc9e1ce0006709b138bd7abd4c22ffb1c39c56b8905810252` |
| TEKSTI | `f9e386263da2dfa84b9abb074d0a0468f77d9f477628e547273e6d0a04efbc9e` |
| PAMJA | `9578df736eb2061d30b0775f3fc05bbe28cc94aa40048e6beed6c305266dde19` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `6e15530457e92482294501c326e40469d8b3d9b80f38aeacbb5a62006eb3e75d` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `a0b332b3aa7ecfa1fb91f9dd35095ec558c07d306f6207fe4bc42429a4dfb028` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/6e15530457e92482294501c326e40469d8b3d9b80f38aeacbb5a62006eb3e75d`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

English



# Parlamenti Europian mbështet Shqipërinë: Hapa të shpejtë drejt anëtarësimit në BE

TemA
19 Shtator 2026, 12:35Politika TEMA



Parlamenti Europian mbështet përpjekjet e Shqipërisë për tu anëtarësuar në BE.

Eurodeputeti slloven, Matjaz Nemec, përgjegjës për Ballkanin Perëndimor, me anë të një videomesazh e konsIderoi anëtarësimin e Shqipërisë si një përgjegjësi të përbashkët, ndërsa bëri një apel për Tiranën, të përfshijë më shumë qytetarët.

"Zgjerimi i BE është një përpjekje e përbashkët BE nuk është thjesht një institucion, ai është një komunitet i ndërtuar mbi vlera të përbashkëta. Rruga e Shqipërisë drejt BE është një përgjegjësi e përbashkët. Parlamenti Europian qëndron përkrah jush në këtë rrugëtim.

Rrugëtimi i Shqipërisë drejt BE nuk është thjesht një proces politik, por një përpjekje e përbashkët që u përket të gjithëve. Zërat, aspiratat, shqetësimet e qytetarëve shqiptarë, duhet të jenë në qendër të këtij debate", tha Matjan Nemec.

Edhe për përfaqësuesin e delegacionit të BE në Shqipëri, Andre Rizzo objektivat për anëtarësim janë realistë, por reformat dhe qytetarët mbeten prioriteti.

"Shqipëria vijon të avancojë në procesin e negociatave me BE. Filloi ti çelë rreth 2 vite më parë, dhe sapo ka filluar ti mbyllë grup-kapitujt. Shqipëria po ashtu ka një objektiv shumë ambicioz. Ti mbyllë këto negociata në 2027 dhe shumë është arritur deri më tani, por ashtu po shumë duhet bërë ende. Reformat janë kyçe, po ashtu edhe qytetarët janë esenciale, për shkak se ndryshimet do të reflektohen direkt mbi ta", u shpreh Andre Rizzo.

Nënkryetarja e re e Kuvendit, Evis Kushi, garantoi se përfshirja e qytetarëve në proceset e dialogut poltiik, do të fillojë nga parlamenti.

"Evropa është shoqëria që duam të ndërtojmë. Një shoqëri demokratike, më gjithëpërfshirëse, më e drejtë, ku institucionet të dëgjojnë, dhe qytetarët marrin pjesë. Ku askush nuk ndihet i lënë pas. Në këtë rrugëtim, Kuvendi do të jetë një hapësirë dialogu, përfaqësimi dhe përgjegjësie", tha Evis Kushi.

Forumi Qytetar "Shqipëria dhe e Ardhmja e Evropës, Qytetarët në Qendër të ZGjerimit të BE", u organizua nga Kuvendi i Shqipërisë në bashkëpunim me Parlamentin Europian.

Synimi i kësaj nisme, është të vendosë zërin e qytetarëve nga Ballkani Perëndimor në qendër të zgjerimit të BE.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[“Pse Berisha s’e mori të shoqen në SHBA?”, Rada: Ja çfarë po ndodh me Aeroportin e Vlorës!]

09:57 Politika / 7 komente

Tabaku: Familjet shqiptare mbyllin muajin me borxh, ndërsa korrupsioni rëndon koston e jetesës (VIDEO)

09:49 Politika / 17 komente

“Prania Besnike”, zbardhen raportimet nga qarqet/ Qindra ankesa të mbledhura, Rama: Procesi duhet të vijojë sipas objektivave

08:45 Politika / 12 komente

Përplasja për pagat, Ngjela: Magjistratët mund t'i rrisin, por nuk i marrin dot! Fondet dalin nga buxheti, për to vendos



Kuvendi

20:10 Politika / 5 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.